



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:**

Lëvizje për Unitet Nacionalë të Turqve – LUNT

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020.

**Qëllimi i revizionit:**

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të liruara nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

Mos zbatimi i parimit të kontabilitetit të ndodhive të modifikuara të transaksioneve/ndryshimeve afariste, mos harmonizimi në raportet financiare të cilat rrjedhin nga vitet e kaluara, si dhe regjistri jo i plotë i kryer i mjeteve, detyrimeve dhe burimeve të mjeteve.

**Mendimi i dhënë/përfundimi\*:**

Shprehën mendim të pavoritshëm për të vërtetën dhe objektivitetin të paraqitur në raportet financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

**Rekomandimet kyçe:**

Evidentimi i ndryshimeve afariste të kryet në përputhje me parimin e kontabilitetit të paraqitjes së modifikuar të ndryshimeve dhe transaksioneve afariste.

Harmonizimi i shumave të deklaruara në librat afarist me ato të deklaruara në raportet financiare.

Kryerja e regjistrimit të plotë dhe harmonizimi i mjeteve, detyrimeve dhe burimeve të mjeteve më 31 dhjetor

**Dobësitë kyçe të sistemit:**

Të rishikohet dispozita ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; saktësimi në pjesën e donacioneve nga partia politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalit të mjeteve, ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore me të cilën rregullohet mënyra e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësisë si burim i financimit.

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:**

Janë marrë vërejtje te draft-raporti i revizorit të autorizuar shtetëror gjatë të cilës është vlerësuar se një vërejtje nuk pranohet, ndërsa vërejtja tjetër paraqet arsyetim për gjendjen e konstatuar.

**Përgjigjet e vërejtjeve të marra:**

Përgjigja e vërejtjeve është dhënë në bashkëngjitje të këtij raporti përfundimtar.

\*



pozitive



me rezervë



të pavoritshëm



të përmbajtur